

Prishtinë, 27 Maj 2009
Kodi i ZRRE-së: V_179_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 15,26, dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Nenin 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
3. Dispozitat e Nenit 37.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dhe
4. Kërkesën e datës 26.12.2008 për vazhdim të licencës furnizim/tregti me energji elektrike dhe për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit me energji elektrike të ndërmarrjes Rudnap Group AD, BLVD Mihaila Pupina 6/21, 11070 New Belgrade, Serbia,

në mbledhjen e mbajtur më 27 Maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

- I. **VAZHDOHET** edhe për **dy (2) vjet** periudha e vlefshmërisë së licencës për furnizim/tregti me energji elektrike Nr. ZRRE_Li_23/07, e lëshuar me datë 23.05.2007 ndërmarrjes Rudnap Group AD.
- II. **Vazhdimi i licencës** do të vlejë nga data 23.05.2009 si datë e skadimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së licencës, e deri më datë 23.05.2011.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.12.2008 nga kompania Rudnap Group AD ka pranuar kërkesën për vazhdim të licencës për Furnizim/Tregti me energji elektrike me Nr. ZRRE_Li_23/07, e datës 23.05.2007 e cila ka skaduar me datë 23.05.2009.
2. Kjo Zyre ka vlerësuar kërkesën e kompanisë Rudnap Group AD dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. ZRRE me rastin e vendosjes për kërkesën në fjalë ka marrë për bazë dispozitat e nenit 37.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare që përcaktojnë se tregtarët e huaj nuk kanë nevojë të regjistrohen si shoqëri tregtare në Kosovë nëse energjia elektrike i dorëzohet një blerësi me shumicë në Kosovë.
4. Kjo licencë e vazhduar i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.

5. Nëse i licencuari dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të furnizimit me energji elektrike të përcaktuara me nenin 4 të licencës, atëherë i njëjti duhet të përmbushë obligimet tjera që përcaktohen me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.
6. Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve , do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar